



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 27
Prishtinë, më 15.11.2018, me fillim në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i Komisionit dhe anëtarët: Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Jasmina Zhivkoviç, Sasha Milosavljeviç, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Duda Balje, Slobodan Petroviç dhe Veton Berisha.

Përfaqësues tjerë: Senad Karaahmetovic (OSBE), Nome Ukaj (KK), Ndriqim Cekaj (KDI), Nikola Gjakoviç (NDI), ambasada Zvicerane Hajrudin Skenderi, Pleurant Kurti (BESR), Zijush Ahmeti(KSZ) dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi z. Igor Simiq- kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projekt Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06 / L-074 me amendamente nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Punës së Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06 / L-057 për Përgjegjshmërinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve me amendamente nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06 / L-087 për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit të pasurisë me amendamente nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Punës së Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06 / L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve me amendamente nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 062 / L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe ndërrimin e pronës së paluajtshme komunale, me amendamente nga Komisioni për Administratë Publike, Vetëqeverisje Lokale dhe Media.**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/1264 / L-077 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 2004/32 mbi Familjen e Kosovës nga Komisioni funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit pa amendamente;**
8. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe kaloi në shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës:

2. **Shqyrtimi i Projekt Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06 / L-074 me amendamente të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.**

Kryetari Igor Simiq, deklaroi se Lista Serbe për këtë Projektligj ia ka përcjellë komisionit funksional 17 amendamente, prej të cilave, asnjë nuk u miratua, ndonëse kishin ndryshime përmbajtjesore të cilat do të kontribuonin në përmirësimin e legjislacionit penal. Gjithashtu, duhet theksuar se nga fillimi i këtij vitit, për të gjitha projektligjet në procedurë, Lista Serbe ka dorëzuar gjithsej 237 amendamente, por të gjitha janë refuzuar. Prandaj anëtarët e Listës Serbe, sot, do të votojnë kundër miratimit të gjitha projektligjeve që janë në rendin e ditës të mbledhjes së Komisionit.

Pastaj, ai ftoi anëtarët e Komisionit të paraqesin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre për këtë çështje. Meqë nuk pati diskutime të tjera, pas votimit:8 (tetë) vota “për” dhe 3 (tre) vota “kundër”. Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projekt kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06 / L-074 me amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj rekomandon që Kuvendi ta miratojë.

Kryesuesi e hapi shqyrtimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06 / L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.**

Pastaj, ai ftoi anëtarët e Komisionit të paraqesin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre për këtë çështje. Meqë nuk pati diskutime të tjera, pas votimit: 8 (tetë) vota “për” dhe 3 (tre) vota “kundër”. Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06 / L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve me amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandon që Kuvendi ta miratojë.

Kryesuesi e hapi shqyrtimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06 / L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, me amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Meqë nuk pati diskutime për Projektligjit me Raportin e Komisionit Funkcional dhe amendamenteve të propozuara, dhe pas rezultateve të votimit, 8 (tetë) “për” dhe 3 (tre) vota “kundër”. Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06 / L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, me amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk i prekë dhe nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit miratim.

Kryesuesi e hap pikën e pestë të rendit të ditës për shqyrtim:

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06 / L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, me amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Meqë nuk pati diskutime për Projektligjin me Raportin e Komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara, dhe pas rezultateve të votimit, 8 (tetë) vota “për” dhe 3 (tre) vota “kundër”. Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06 / L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, me amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit miratim.

Kryesuesi e hapi shqyrtimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 062 / L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe ndërrimin e pronës së paluajtshme komunale, me amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Meqë nuk pati diskutime rreth Projektligjit me Raportin e Komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara dhe pas rezultatit të votimit, 8 (tetë) vota “për” dhe 3 (tre) vota “kundër”. Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

1. Projektligjit nr. 062 / L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe ndërrimin e pronës së paluajtshme komunale, me amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Kryesuesi e hapi shqyrtimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/1264 / L-077 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 2004/32 për familjen e Kosovës, nga Komisioni funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, pa amendamente

Meqë nuk pati diskutime për Projektligjin, me Raportin e Komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara dhe pas rezultateve të votimit, 8 (tetë) vota “për” dhe 3 (tre) vota “kundër”. Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/1264 / L-077 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 2004/32 për familjen e Kosovës, nga Komisioni funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, pa amendamente, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetje të Komisionit

Kryetar i Komisionit

Igor Simiq